



Prishtinë: 02.09.2021  
Kodi i ZRRE-së: V\_1386\_2021

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_2121\_01\_21**;
- Ankesën e konsumatorit të dt. 29.05.2021;

në seancën e mbajtur më datë **02.09.2021** nxori këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit H.M nga Komuna e Prishtinës, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK\_V\_2121\_01\_21, i datës 27.01.2021.

### A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve në ZRrE me datë 27.01.2021 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK\_V\_2121\_01\_21, me të cilin e ka refuzuar ankesën e konsumatorit H.M nga Komuna e Prishtinës, lidhur me kontestimin e faturës së energjisë elektrike të dt.26.02.2018.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori H.M, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRrE-së për këto shkaqe:

- Vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, shkeljes esenciale të dispozitave procedurale dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale;
- Se borxhi është parashkruar, në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Ligji nr.04/L-077;
- Se vendimi nuk është nxjerrë brenda afatit ligjor sipas dispozitave ligjore të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Ligji nr.05/L-031 (heshtja administrative).
- Konsumatori H.M kërkon nga Bordi i ZRRE-së që të anulohet vendimin e DMK-së ZRRE/DMK\_V\_2121\_01\_21 i datës 27.01.2021.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin e konsumatorit se vendimi i shkallës së parë e ka vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë gjendjen faktike, dhe se ka shkelje të dispozitave materiale dhe procedurale, Bordi i



ZRrE-së thekson se këto pretendime si të tilla nuk qëndrojnë, sepse si nga organi i shkallës së parë, po ashtu edhe nga organi i shkallës së dytë, janë administruar provat si në vijim: fatura nr.02180 e dt.26.02.2018, ankesa e konsumatorit në KESCO e dt. 28.04.2018, procesverbali i inspektimit nr.0942563 i dt.19.03.2018, procesverbali i kontrollimit detal të njehsorit elektrik nr.org.16559 i dt.19.06.2018, përgjigja e KESCO-s e dt.07.07.2018, ankesa e konsumatorit e dt.23.07.2018, dhe pas analizimit të të gjitha provave të sipërshënuara është konstatuar kjo gjendje faktike:

- Njehsori elektrik është në rregull, bllokat (vulat) i ka në rregull, nga ana e jashtme dëmtime nuk ka si dhe gabimi është 0.38%, dhe si i tillë, sipas dispozitave të Kodit të Matjes **është brenda kufirit të lejuar të matjes prej +2.5%**;
- Janë analizuar edhe listat e leximit për periudhën 08/2017 dhe 04/2018 dhe është konstatuar se **lexuesi KEDS ka bërë inspektim dhe lexim të rregullt mujor**;
- Shpenzimet e konsumatorit të evidentuara në CCP për periudhën shkurt 2018 **përputhen me procesverbalin** e inspektimit nr.0942563 të dt.19.03.2018;
- Duke u bazuar në Rrjedhën e Energjisë Elektrike, respektivisht nenin 28, Bordi ka konstatuar se konsumatori **është faturuar sipas** dispozitave ligjore në fuqi.

Andaj, në harmoni me nenin 48 të Ligjit nr.05/L-031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative, Bordi i ZRrE-së i ka vlerësuar të gjitha pretendimet e ankuesit dhe i ka analizuar të gjitha dëshmitë dhe provat që lidhen më rastin në fjalë dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Lidhur me pretendimin e dytë se ky borxh është parashkruar, Bordi i ZRrE-së ka vlerësuar se në kuptim të nenit 369 të Ligjit nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, në mënyrë decisive përcaktohet si vijon: *“Parashkrimi ndërpritet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarr kundër debitorit para gjykatës ose autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”*. Duke qenë se në rastin në fjalë, janë ndërmarr disa veprime procedurale administrative tek autoritetet kompetente si furnizuesi i licencuar (KESCO) dhe ZRrE si institucion publik kompetent për trajtimin e këtyre ankesave, si bie fjala ankesa tek furnizuesi, përgjigja e furnizuesit, ankesa tek ZRrE, vendimi i shkallës së parë të ZRrE-së etj, atëherë, me të drejtë mund të konstatojmë se nuk kemi të bëjmë me situatë të parashkrimit të këtij borxhi, pasi që pas çdo veprimi procedural që është ndërmarrë, është shkaktuar situata juridike e ndërprerjes së afatit të parashkrimit.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

---

Ymer Fejzullahu, Kryesues

---

Selman Hoti, anëtar

---

Izet Rushiti, anëtar

---

Lutfije Dervishi, anëtare

---

Gani Buçaj, anëtar

**Vendimi u dërgohet:**

- KESCO-së,
- Konsumatorit H.M dhe
- Arkivit të ZRRE-së.